

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-173/11

Prishtinë, 26 korrik 2012

Në çështjen juridike të:

Đ. M. P.

Paraqitësi i kërkesës/Ankuesi

Kundër

R. H.

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

dhe

X. ZH.

Pala e dytë përgjegjëse në kërkesë/Pala e dytë përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva - Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/108/2011 (lëndët janë të regjistruara në AKP me numrat KPA20160 dhe KPA20161), i datës 13 maj 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 26 korrik 2012, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Ankesat e paraqitura nga **Đ. P.** me datë 3 tetor 2011, të regjistruara me numrat **GSK-KPA-A-173/11** dhe **GSK-KPA-A-174/11**, janë bashkuar në një lëndë të vetme me numër **GSK-KPA-A-173/11**.
- 2- Ankesat e paraqitura nga **Đ. P.** me datë datë 3 tetor 2011, refuzohen si të pabazuara.
- 3- Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës **KPCC/D/A/108/2011**, i datës 13 maj 2011, për sa i takon lëndëve të regjistruara me numrat **KPA20160** dhe **KPA20161**.
- 4- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 55 (pesëdhjetë e pesë) brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 4 dhjetor 2006, **Đ. M. P.**, duke vepruar si anëtar i familjes dhe në emër të babait të tij tanimë të ndjerë, ka parashtruar disa kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e së drejtës së pronësisë dhe ri-posedimin e ngastrave: Nr. 726/2, në vendin e quajtur "Ljigata", arë e klasës së 3-të, me sipërfaqe prej 16 ari e 79 m² dhe Nr. 728/1, në vendin e quajtur "Ljigata", arë e klasës së 3-të, me sipërfaqe prej 18 ari e 49 m². Ai ka shpjeguar se këto ngastra kadastrale kanë qenë të babait të tij M. S. P., dhe të cilat ishin uzurpuar.

Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:

- Certifikatën e tij të lindjes, të lëshuar me datë 2 nëntor 1998 nga Komuna e Vushtrrisë, Republika e Serbisë;
- Transkripti i Fletës Poseduese Nr. 221, të lëshuar me 6 shtator 1999 nga Komuna e Vushtrrisë, Zona Kadastrale e Gracës, Republika e Serbisë; dhe
- Leternjoftimin, të lëshuar me datë 19 mars 1997 nga Komuna e Vushtrrisë, Republika e Serbisë.

Fleta Poseduese Nr. 221, ka konstatuar se M. S. P. , ishte pronar i ngastrave të kërkuara në Komunën e Vushtrrisë, Zona Kadastrale e Gracës.

Më vonë gjatë procedurës, paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar edhe këto dokumente:

- Certifikatën e vdekjes së bartësit të së drejtës pronësore, lëshuar me datë 26 tetor 2007 në Krlevë, Komuna e Vushtrrisë, Republika e Serbisë;
- Kopjen e Planit Nr. 953-1/2010-80, lëshuar me datë 10 mars 2010 nga Zyra Kadastrale e Vushtrrisë, Republika e Serbisë;
- Kopjen e Planit Nr. 953-1/2010-182, lëshuar me datë 28 maj 2010 nga Zyra Kadastrale e Vushtrrisë, Republika e Serbisë;
- Transkriptin Nr. 952-1/2010-2123 të Fletës Poseduese Nr. 221, lëshuar me datë 28 maj 2010 nga Zyra Kadastrale e Vushtrrisë, Republika e Serbisë;
- Kopjen e Planit Nr. 953-1/2010-284, lëshuar me 24 gusht 2010;
- Kopjen e Planit Nr. 953-1/2010-312, lëshuar me datë 15 shtator 2010 nga Zyra Kadastrale e Vushtrrisë, Republika e Serbisë;

Njoftimet e para të bëra nga AKP-ja me 19 mars 2007 (KPA20161) dhe 29 gusht 2007 (KPA20160 dhe KPA20161) ishin të pasakta. Prandaj, ekipi i njoftimit të AKP-ës me datën 16 shtator dhe 6 tetor të vitit 2010 ka shkuar në vendet ku pretendohet se ndodheshin ngastrat e kërkuara dhe ka vendosur shenjat që tregojnë se pronat ishin objekt kontesti të kërkesave dhe se palët e interesuara duhet t'i paraqisnin përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve. Të dyja ngastrat ishin gjetur të uzurpuara.

Konfirmimet (për KPA20160 me 27 shtator 2010 dhe për KPA20161 me 22 tetor 2010) e njoftimeve të sipërcekura ishin bërë nga AKP-ja në bazë të hartës kadastrale, ortophotos dhe koordinatave të GPS dhe njoftimet ishin gjetur në rregull.

Mbi bazën e Fletës Poseduese Nr. 221 të dorëzuar, zyrtarët e AKP-ës kanë gjetur Fletën Poseduese Nr. 221 të Kombeve të Bashkuara, të lëshuar me datë 25 shtator 2007 nga Komuna e Vuçitërnës për Zonën Kadastrale të Gracës, dhe Certifikatën Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme Nr. UL-70202022-00221, të lëshuar me datë 27 gusht 2010 nga Komuna e Vushtrrisë, që konstaton se parcelat që kërkohen ishin në posedim të M. S. P. - babait të paraqitësit të kërkesës - si pronarë i këtyre palujtshmërive. Të dyja certifikata e lindjes e paraqitësit të kërkesës dhe certifikata e vdekjes së bartësit të së drejtës pronësore kanë mundur të verifikohen.

AKP-ja kishte kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzoj çertifikatën e vdekjes së babait të tij (bartësit të së drejtës pronësore) dhe e kishte pyetur atë nëse kishte filluar procedura e trashëgimisë. Parashtruesi i kërkesës ishte përgjigj se babai i tij kishte vdekur me 22 Mars 1993 dhe se nuk ishte filluar procedura për trashëgimi.

Me 20 tetor 2008, pas që ishin bërë njoftimet të para të pasakta të pronave nga AKP-ja, **R. H.** (tani e tutje: *pala e parë përgjegjëse në kërkesë*) ka paraqitur përgjigje në kërkesën e parashtruar në AKP, duke cekur se në vitin 2001 ai i kishte blerë parcelat e kërkuara objekte kontesti të këtyre lëndëve nga paraqitësi i kërkesës **Đ. P.**, kur edhe kishte lidhur kontratë interne me të. Sipas tij, kjo kontratë nuk ishte vërtetuar në gjykatë për shkak se në atë kohë gjykatat nuk ishin funksionale.

Në mbështetje të këtij konstatimi, pala e parë përgjegjëse ka paraqitur një kopje të autorizimit të pa datë, pa nënshkrim dhe të pa vërtetuar të autorizimit të dhënë nga S. P. (gruaja e bartësit të së drejtës pronësore dhe e ëma e paraqitësit të kërkesës), me të cilin ajo autorizonte djalin e saj – paraqitësin e kërkesave – të hyjë dhe nënshkruaj në emër dhe llogarinë e saj kontratën e shitëblerjes për 1/3 e pjesës ideale të palujtshmërive që evidentohen në Fletët Poseduese: Nr. 221 dhe Nr. 222, rrespektivisht që të pranoj çmimin shitë-blerës të kontraktuar për këto palujtshmëri.

Më tutje, pala e parë përgjegjëse në kërkesën e parashtruar ka ofruar në AKP edhe një deklaratë, që sipas tij, ishte dhënë nga paraqitësi i kërkesës dhe ishte vërtetuar me 18 maj 2001 në Gjykatën Komunale në Vërshac, Serbi, në të cilën mund të lexohet se ai pranonte se nënshkrimi në kontratën e shitëblerjes së sipërcekur ishte i tij. Raporti i verifikimit i AKP-ës, i datës 8 dhjetor 2010, konfirmon se kjo deklaratë është dhënë nga paraqitësi i kërkesës para Gjykatës Komunale të Vërshacit me 18 maj 2001, nën numrin VR.Nr. 1085/2010.

Me datën 2 shkurt të vitit 2010, AKP-ja kishte kontaktuar paraqitësin e kërkesës dhe e kishte pyetur atë për pretendimet e palës së parë përgjegjëse në të cilat ai theksonte se në mesin e ngastrave të tjera kadastrale të regjistruara në fletën poseduese Nr. 221, nga ai (**Đ. P.**) kishte blerë edhe ngastrat: Nr. 726/2 dhe Nr. 728/1. Paraqitësi i kërkesës ishte përgjigjur se shitja e pretenduar e palujtshmërive të kërkuara nga ana e tij palës së parë përgjegjëse në kërkesë mbi bazën e kontratës interne nuk ishte bërë. Për më tepër, ai kishte theksuar se ai me familjen e tij si dhe nëna e tij S. P. kishin në posedim dhe shfytëzim pronat e kërkuara deri me 2004.

Në ndërkohë, me datë 23 shtator 2010 (pas njoftimeve të përsëritura dhe saktë të bëra nga AKP-ja), **Xh. ZH.** (tani e tutje: *pala e dytë përgjegjëse në kërkesë*) në njoftimin e pranuar dhe të nënshkruar mbi pjesëmarrjen në procedurë, kishte shprehur interesimin e tij që të marrë pjesë në procedurat ligjore pranë KKKP-ës.

Gjithashtu, në kontaktin tjetër (me 28 tetor) në mes të AKP-ës dhe paraqitësit të kërkesës, paraqitësi i kërkesës kishte rikonfirmuar se ai me familjen e tij si dhe nëna e tij S. P. ishin në posedim dhe shfytëzim të pronave të kërkuara (Nr. 726/2 dhe Nr. 728/1) deri me 2004. Për më shumë në këtë komunikim, paraqitësi i kërkesës deklaroi se pronat e kërkuara ishin uzurpuar në mënyrë të paligjshme nga pala përgjegjëse pas vdekjes së nënës së tij dhe se nuk ishte inicuar kurrfarë procedure e trashëgimisë.

Për të mbështetur dhe vërtetuar deklaratimet e tija të sipërcituara, paraqitësi i kërkesave me datë 10 nëntor 2010, i kishte ofruar AKP-ës edhe një deklaratë të shkruar të tij, përmes së cilës ai theksonte se palujtshmëritë e evidentuara në emër të babait të tij M. P. nuk ishin shitur, për faktin se sipas tij askush s'kishte të drejtë ligjore të bënte këtë, duke mohuar se autorizimi dhe deklaratat e dhënë ishin konfirmuar nga ai si tërëshëgimtar i palujtshëmëve. Veç kësaj në të njëjtën deklaratë theksonte se S. P. , bashkëshortja e bartësit të të së drejtës pronësore dhe e ëma e tij, kishte qenë në posedim të ngastrave të kërkuara deri me datën 30 dhjetor 2004, që korrespondon edhe me ditën e saj të vdekjes.

Përfundimisht, AKP-ja me datën 17 dhjetor 2010 dhe 3 shkurt 2011 kishte kontaktuar përsëri paraqitësin e kërkesave dhe e kishte pyetur edhe njëherë atë nëse pretendimet e palës përgjegjëse në kërkesë dhe përgjigja e tij ishte e njëllotë sikur edhe në deklaratimet e mëparshme – se ai me familjen e tij si dhe nëna e tij S. P. kishin në posedim dhe shfytëzim pronat e kërkuara (edhe palujtshmëritë e kërkuara: Nr. 726/2 dhe Nr. 728/1) deri me 2004. Veç kësaj në këtë komunikim paraqitësi i kërkesës thekson se pronat e kërkuara ishin uzurpuar nga pala e parë përgjegjëse në kërkesë pas vdekjes së nënës së tij.

Me datë 28 shkurt 2011, AKP-ja kishte kontaktuar palën e dytë përgjegjëse në kërkesë dhe e kishte pyetur atë për pretendimet e tija pronësore në parcelat No. 726/2 dhe No. 728/1. Ai ishte përgjegjur se i kishte blerë pronat e kërkuara me datë 25 shkurt 1977 nga M. P. . Kishte deklaruar edhe se kishte paguar në tërësi çmimin e shitëblerjes, por që tatimin në qarkullim sipas tij duhejt ta paguante M. P., por që në kohën kur duhejt të bëheshin ndryshimet kadastrale, ai kishte refuzuar të paguante këtë tatim, prandaj edhe palujtshmëria nuk kishte kaluar në emër të tij (palës së dytë përgjegjëse në kërkesë).

Më tutje, sipas tij në vitin 1984 kur edhe kishte ngjarë komosacioni, babai i paraqitësit të kërkesës kishte shkruar të ai dhe i kishte dorëzuar atij dokumentacionin mbi komosacionin në emër të tij (në emër të **Xh. Zh.**). Përfundimisht, në deklaratimin e tij, pala e dytë përgjegjëse thekson se që nga ajo kohë ai i posedon këto dy palujtshëmëri dhe se babai i paraqitësi të kërkesave asnjëherë nuk kishte qenë kundër kësaj, dhe se ndoshta djali i tij nuk është në dijeni për këtë. Në mbështetje të konstatimeve të tija ai i kishte ofruar AKP-ës procesverbalet mbi vërtetimin e gjendjes faktike Nr. (të palëxuara) të lëshuara në fshatin Gracë dhe fshatin Stanovc i Poshtëm, Komuna e Vushtrrisë.

Me datë 28 shkurt 2011 (në të njejtën datë), AKP-ja kishte kontaktuar edhe paraqitësin e kërkesave dhe e kishte pyetur atë në lidhje me pretendimet e palës së dytë përgjegjëse në kërkesë, se ai i kishte blerë palujtshmëritë e kërkuara. Paraqitësi i kërkesës ishte përgjigj se në bazë të njohurive që ai kishte, babai i tij i ndjerë nuk ia kishte shitur palujtshmëritë **Xh. Zh.** dhe se ata ishin nën posedim të nënës së tij S. P. deri në fundin e vitit 2004 kur edhe kishte vdekur.

Edhe me datë 15 mars 2011, AKP-ja kishte kontaktuar paraqitësin e kërkesave dhe e kishte pyetur atë për deklarimin e palës së dytë përgjegjëse në kërkesë, se ai i kishte në posedim pronat e kërkuara (ngastrën kadastrale no. 726/2 dhe 723/1) që nga viti 1977. Paraqitësi i kërkesës ishte përgjegjur se nuk është e vërtetë se këto parcela ishin blerë dhe as që ishin shfrytëzuar nga pala e dytë përgjegjëse dhe se nëna e tij S. P. i kishte në shfrytëzim të gjitha parcelat që ishin të regjistruara në Fletën Posedues Nr. 221, duke përfshirë edhe këto dy parcela të kërkuara deri në vitin 2004 kur edhe kishte vdekur.

Me datë 14 prill 2011 pala e parë përgjegjëse në kërkesë (**R. H.**) kishte dhënë një deklaratë në të cilën ka theksuar se i kishte blerë disa parcela nga **Dj. P.**, por nuk e kishte ditur saktësisht se cilat ishin ato parcela. Më tutje ai thekson se parcelat që janë objekt kontesti të lëndëve në fjalë i takojnë palës së dytë përgjegjëse në kërkesë (**Xh. Zh.**) dhe për këtë ai është vënë në dijeni në kohën kur ekipi i njoftimit të AKP-ës kishte vizituar parcelat. Meqenëse, sipas tij këto parcela janë në posedim të palës së dytë përgjegjëse në kërkesë, qysh para 20-30 vitesh, ai edhe ka kërkuar largimin e tij nga procedura.

Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) me vendimin e tij KPCC/D/A/108/2011, i datës 13 maj 2011, ka hedhë të gjitha kërkesat, pasi që ato nuk kanë qenë nën juridiksionin e KKPK-së. Nën Nr. 42 të Vendimit ndër të tjera thuhet si në vijim “ Paraqitësi i kërkesës deklaroi se nëna e tij S. mbajti posedimin e pronave të kërkuara deri në dhjetor të vitit 2004”. Pastaj, nën Nr. 47 të të njejtit Vendim ndër të tjera thuhet “..... Paraqitësi i kërkesës pohon se nëna e tij mbeti në posedim të pronave deri në dhjetor të vitit 2004, mjaft kohë pas mbarimit të konfliktit të armatosur në Kosovë.” Me tutje në të njejtin numër të vendimit thuhet “..... Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se nuk ka pasur humbje të posedimit për shkak të konfliktit të vitit 1998-99, por pas vdekjes së nënës së tij në vitin 2004, pronat u uzurpuan nga persona të panjohur”. Në këto rrethana, Komisioni vjen në përfundim si në vijim “kërkesat duhet të hidhen poshtë pasi bien jashtë juridiksionit të Komisionit”.

Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës me 23 shtator 2011. Pala e parë përgjegjëse në kërkesë e ka pranuar vendimin me datë 12 shtator 2011, ndërsa pala e dytë përgjegjëse e ka pranuar atë me datë 12 shtator 2011.

Me 3 tetor 2011, paraqitësi i kërkesës (më tutje në tekst: “ankuesi”) ka paraqitur ankesat në Gjykatën Supreme, duke kundërshtuar vendimin e KKPK-së për shkak të: (a) vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe (b) aplikimit jo të drejtë të së drejtës materiale.

Gjendje faktike e vërtetuar gabimisht në vendimin e Komisionit sipas ankuesit qendron në citimin e pasaktë të deklaratës së tij si në vijim *“nëna e tij e ndjerë ishte në posedim të palujtshmërive deri në dhjetor të 2004, kur edhe kishte vdekur”*. Për më tepër ai thekson si në vijim *“është plotësisht i pasaktë fakti se kjo është mbështetur në deklaratën e tij”*.

Më tutje ai në ankesën e tij deklaron se nuk kishte thënë asnjëherë se nëna e tij ishte në posedim të palujtshmërive deri në vdekjen e saj. Për më tepër ai thekson se familja e tij kishte humbur posedimin e palujtshmërive pas largimit nga Kosova në vitin 1999 dhe se ata nuk ishin në posedim të tyre në kohën e paraqitjes së kërkesës, ashtu siq nuk janë as sot.

Për më shumë në ankesat e tij ai i referohet edhe një vendimi tjetër të Komisionit KPCC/D/R/23/2008, i datës 28 Gusht 2010, që i referohet kërkesës së paraqitur pranë AKP-ës me numër KPA20162 (numri i Kolegjit të Apelit të AKP-ës për këtë lëndë është GSK-KPA-A-92/11), që ka të bëjë me parcelen nr. 789/2 – shtëpi, në sipërfaqe prej 83 m², e cila është e regjistruar njëjtë sikur edhe palujtshmëritë tjera në Fletën Poseduese Nr. 221, duke pohuar se AKP-ja kishte vendosur në kërkesën e tij duke vërtetuar se babai tanimë i ndjerë i paraqitësit të kërkesës ishte pronar. Më tutje, sipas tij në këto kërkesa: KPA20163, KPA20164, KPA20165, KPA20166, KPA20167, KPA20168, KPA20169, KPA20161 dhe KPA20160 (Kolegji i Apelit të AKP-ës i ka bashkuar të gjitha këto kërkesa në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-92/11) AKP-ja nuk ka vërtetuar faktin se nëna e tij ishte në posedim të pronës deri në dhjetor të 2004, paraqitësi i kërkesës më tutje thekson se është jologjike që dikush të jetë në posedim të tokës dhe jo në posedim të shtëpisë. Situata tjetër e kundërt kur dikush posedon shtëpinë dhe jo tokën do të ishte më shumë logjike. Pra, sipas tij Komisioni i AKP-ës ka konstatuar dhe vendosur ndryshe për rastet e njejta.

Sipas ankuesit meqënëse gjendja faktike është aplikuar gabimisht edhe e drejta materiale rrespektivisht neni 3 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 është zbatu në mënyrë jo të drejtë.

Pala ankuese kërkon që vendimet për ankesat të jenë në favorin e tij, në mënyrë që ai të riposedoj pronat e kërkuara dhe të regjistruara në emër të babait të tij.

Ankesa i është dorëzuar palës së parë përgjegjëse në kërkesë (më tutje në tekst: “pala e parë përgjegjëse në ankesë”) me 11 tetor 2011, ndërsa palës së dytë përgjegjëse në kërkesë (më tutje në tekst: “pala e dytë përgjegjëse në ankesë”) me 7 tetor 2011. Palët përgjegjëse në ankesë nuk kanë reaguar.

Gjykata Supreme i ka bashkuar ankesat

Arsyetim ligjor:

Bashkimi i ankesave:

Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, përcakton se Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkriura, kur për bashkimin apo shkrirjen e kërkesave është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të kësaj Rregulloreje. Ky nen i mundëson Komisionit që të marrë në konsideratë bashkimin ose shkrirjen e kërkesave me qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.

Neni 408.1, në lidhje me nenin 193 të Ligjit Nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore, i zbatueshëm në procedurën e apelit pranë Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, parsheh mundësinë e bashkimit me aktvendim të të gjitha ankesave nëse ky bashkim i kontribon efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Në tekstin e ankesave të parashtruara nga ana e ankuesit, Gjykata Supreme konstaton se përveq numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën saktësisht ushtrohet ankesa përkatëse, e gjitha baza faktike dhe ligjore, si dhe çështja e provave është plotësisht e njëjtë në të 2 (dy) lëndët. Vetëm parcelat, objekte të së drejtës pronësore, të cilat pretendohen në secilën kërkesë janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më shumë edhe arsyetimi ligjor i dhënë nga ana e Komisionit për kërkesat është i njëjtë. Prandaj, qartazi shihet se bashkimi i ankesave do të ishte me i efektshëm.

Ankesat e regjistruara nën numrat GSK-KPA-A-173/11 dhe GSK-KPA-A- 174/11 janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruar nën numrin GSK-KPA-A-173/11.

Pranueshmëria e ankesave:

Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për vendimin.

Në rastin konkret vendimet e KKPK-ës i janë dorëzuar ankuesit me datë 23 shtator 2011, i cili edhe ka qenë palë në procedurën e instancës së parë, ndërsa ankesat nga ana e tij janë parashtruar me datë 3 tetor 2011, e që është më pak se 30 ditë nga dita e pranimit të njoftimit mbi vendimet e KKPK-ës.

Ankesat janë të pranueshme.

Meritat:

Gjykata Supreme e Kosovës vëren se në bazë të dokumentacionit të siguruar nga paraqitësi i kërkesës dhe raporteve të verifikimit të Sekretariatit Ekzekutiv, Komisioni ka vlerësuar si duhet se humbja e posedimit mbi pronat e kërkuara nuk ishte rezultat i lidhshmërisë me rrethanat e konfliktit të armatosur të vitit 1998-1999 dhe në të njëjtën kohë ka vendosur drejtë kur kërkesat i ka hedhur poshtë.

Gjykata Supreme dëshiron të theksojë se KKPK-ja nuk e ka cekur pasaktësisht ankuesin, ashtu siq është theksuar në ankesat e ushtruara. Në deklaratën e tij të paraqitur nga vet ai në AKP me datë 10 nëntor 2010 ankuesi theksonte se bashkëshortja e bartësit të së drejtës pronësore S. P., që ishte edhe nëna e tij, kishte qenë në posedim dhe shfrytëzim të pronave të kërkuara deri me 30 dhjetor 2004, kohë që korrespondonte edhe me ditën e vdekjes së saj. Të njëjtat deklaratime rivërtetohen edhe me pohimet e ankuesit përgjatë kontaktit me AKP-ën të dhëna nga ai në vitin 2010 dhe 2011. Prandaj, nga gjendja e tillë gjykata gjen se nuk kemi të bëjmë me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, si bazë reale e pretenduar për paraqitjen e ankesës nga ankuesi.

Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai apo ajo nuk është në gjendje t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurti 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Megjithatë, paraqitësi i kërkesës në këtë rast nuk ka vërtetuar se është i kufizuar në ushtrimin e të drejtave të kërkuara pronësore për shkak të konfliktit të armatosur të vitit 1998/1999. Pala ankuese nuk pohon se ai apo nëna e tij është dashur të largohen nga prona për shkak të konfliktit të armatosur. Përkundrazi, pala ankuese deklaron disa herë, gojarisht dhe në formë të shkruar se nëna e tij – bashkëshortja e bartësit të së drejtës pronësore - kishte qenë në posedim të ngastrave të kërkuara deri me datën 30 dhjetor 2004.

Prandaj, nuk ka ndonjë shenjë apo madje ndonjë provë se paraqitësi i kërkesës e kishte humbur pronën si rezultat i konfliktit të armatosur në Kosovë në vitin 1998/1999. Përkundrazi, faktet e dhëna nga ankuesi japin arsye për të besuar se prona ishte humbur pas vdekjes së nënës së tij në vitin 2004.

Prandaj, pasi që kërkesa është jashtë juridiksionit të KKPK-së, KKPK-ja nuk ka vendosur rreth pronësisë së palës ankuese dhe në këtë mënyrë edhe nuk ka pasur nevojë të lëshohet në shqyrtim të mëtutjeshëm në këtë çështje. Në vijueshmëri të gjithë kesaj që u tha Gjykata Supreme gjen se në vendimin e KKPK-ës nuk janë përfshirë shkelje të së drejtës materiale, si bazë tjetër reale e pretenduar dhe e theksuar për paraqitjen e ankesës nga ana e ankuesit.

Gjykata Supreme refuzon ankesat e sipërcekura dhe rezultativisht bazuar mbi arsyetimin ligjor të mësipërm, vërteton vendimin e KKPK-ës. Gjykata dëshiron të shtojë se, mbi bazën e gjendjes së njejtë faktike dhe juridike, të gjitha gjitha lëndët paralele janë vendosur në të njejtën mënyrë.

Përfundimisht, ky vendim nuk prejudikon të drejtën e ankuesit të kërkoj vërtetimin e së drejtës pronësore mbi palujtshmëritë objekt të kontestit, para gjykatës kompetente vendore.

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrativ (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifata e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10,11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10,21, 10,12 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pasur parasysh se vlera e pronës së kërkuar më arsye mund të vlerësohet në € 4000: € 25

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesi që humb rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata Supreme vendos që në rastin konkret, shpenzimet gjyqësore duhet të paguhen nga ankuesi në afat prej 90 ditësh nga dita kur aktgjykimi i është dorëzuar atij. Neni 47.3 parashih që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva - Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Phil Drake, Shef i Shkrimoreve të EULEX-it